RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0084/26
Data 14.09.2026
PRISHTINË

RTK
RADIOTELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Konkluzat, Vendimet, Rekomandimet dhe Kërkesat e nxjerra në mbledhjen e Bordit të RTK-së, me datë 09.09.2026

1. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, raportet e paraqitura para Bordit të shoqërohen me analizë krahasuese me periudhat përkatëse të vitit paraprak dhe/ose muajt paraprakë, duke evidentuar rritjet, rëniet dhe ndryshimet kryesore, si dhe arsyet e tyre.

2. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes menaxhmentit, të sigurojë paraqitjen e një raporti mbi realizimin e programit, duke e krahasuar atë me skemën programore të planifikuar dhe duke evidentuar devijimet, ndryshimet dhe arsyet përkatëse.

3. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes strukturave përgjegjëse, të sigurojë që raportimi financiar mujor të paraqitet në mënyrë të harmonizuar dhe të përputhur, duke ndarë qartë bilancin fillestar, financimin e pranuar, të hyrat vetanake, shpenzimet dhe bilancin përfundimtar, si dhe të korrigjohet terminologjia dhe çdo mospërputhje numerike e evidentuar në raportin e muajit korrik.

4. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes Departamentit të Financave dhe Departamentit të Marketingut, të sigurojë raportim të harmonizuar, duke ndarë së paku vlerën e kontratave, faturimin, inkasimin, kompensimet, parapagimet dhe llogaritë e arkëtueshme.

5. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes strukturave përgjegjëse, të hartohet dhe t'i paraqitet Bordit një plan për mbrojtjen e arkivit digjital të RTK-së dhe infrastrukturës kritike, me masa, kosto dhe afate konkrete për kopjet rezervë të arkivit, ruajtjen e tyre në sisteme dhe lokacione të sigurta, sigurimin e kapaciteteve rezervë, mbrojtjen nga zjarri dhe testimin periodik të rikthimit të të dhënave.

6. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes strukturave përgjegjëse, t'i paraqitet Bordit një pasqyrë e plotë e fuqisë punëtore, me shpërndarjen sipas njësive dhe profileve profesionale, numrin real të punonjësve aktivë, detyrat që ushtrojnë në praktikë, mungesat, si dhe identifikimin e njësive me tepricë ose mungesë të stafit.

7. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes strukturave përgjegjëse, të identifikohen funksionet dhe pozitat kritike ku RTK-ja nuk ka rezervë operative dhe të paraqitet plan për eliminimin e varësisë nga një punonjës, pajisje ose funksion i vetëm, në

rastet kur mungesa ose dështimi i tyre mund të rrezikojë proceset programore apo teknike.

8. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes strukturave përgjegjëse, t'i paraqitet Bordit raport mbi gjendjen e zbatimit të rekomandimeve të Auditimit të Brendshëm që lidhen me përshkrimet e vendeve të punës, sistematizimin, avancimet dhe pabarazitë eventuale në detyra dhe pagesa, si dhe afati për përfundimin e sistematizimit.

9. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes strukturës përgjegjëse për strategji dhe zhvillim, t'i paraqitet Bordit afati i përfundimit të dokumentit strategjik, si dhe objektivat e matshme për periudhën 2026–2027 dhe periudhat vijuese.

10. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes strukturave përgjegjëse, mospërputhjet e evidentuara në raportime të korrigjohen, ndërsa çështjet kritike të identifikuara të shoqërohen me masa konkrete, përgjegjësi të përcaktuara dhe afate të realizimit, në mënyrë që raportimi i ardhshëm t'i mundësojë Bordit jo vetëm vlerësimin e aktiviteteve të realizuara, por edhe mbikëqyrjen e rreziqeve, shmangieve nga objektivat dhe masave korrigjuese.

11. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes Departamentit të Marketingut dhe në bashkëpunim me Departamentin e Financave, të sigurojë korrigjimin e gabimeve numerike dhe përqindjeve të pasakta të evidentuara në raportin gjashtëmujor të Marketingut, si dhe që, para paraqitjes së raporteve të ardhshme në Bord, të dhënat financiare dhe komerciale të verifikohen dhe të përputhen me të dhënat e Departamentit të Financave.

12. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes Departamentit të Marketingut, të sigurojë që raportimi i Marketingut të dallojë qartë vlerën e kontratave të lidhura, faturimin, inkasimin, llogaritë e mbetura për arkëtim dhe kontratat me kompensim, në mënyrë që vlera e kontratave të mos paraqitet ose interpretohet si e hyrë e realizuar.

13. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, të përcjell Bordit rregulloren/dokumentin për kontratat me kompensim, i/e cila përcakton mënyrën e aprovimit, vlerësimin e mallrave dhe shërbimeve, nevojën institucionale për to dhe kufirin e pranueshëm të kompensimeve në raport me të hyrat monetare.

14. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes Departamentit të Marketingut dhe strukturave të tjera përkatëse, të sigurojë që konstatimet në raportet zyrtare lidhur me rënien e besueshmërisë, menaxhimin joefikas, shikueshmërinë apo qëndrimet e klientëve të mbështeten me të dhëna ose dëshmi të dokumentuara dhe të bëhet dallim i qartë ndërmjet të dhënave të matshme, vlerësimeve të klientëve dhe opinioneve të vetë departamentit.

15. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes Departamentit të Marketingut dhe strukturave përkatëse, analiza krahasuese me transmetuesit publikë të rajonit të rishikohet duke përdorur periudha, kategori të të hyrave dhe tregues të krahasueshëm, në mënyrë që përfundimet mbi pozitën konkurruese të RTK-së të mbështeten në një metodologji të njëtrajtshme.

16. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes Departamentit të Marketingut, plani i Marketingut për gjashtëmujorin e dytë të shoqërohet me objektiva të matshme, duke përfshirë së paku të hyrat e synuara, klientët e rinj, numrin e ofertave, kontratat e lidhura, shkallën e shndërrimit të kontakteve në kontrata dhe nivelin e inkasimit.

17. Kërkohet nga Drejtoresha e Përgjithshme e RTK-së që, përmes Departamentit të Marketingut, raportimi i ardhshëm të fokusohet jo vetëm në numrin dhe vlerën e kontratave, por në të hyrat e realizuara, arkëtueshmërinë, kostot e gjenerimit të tyre dhe kontributin real financiar për RTK-në.

Xheraldina Cërnobregu

Nënkryetare e Bordit të RTK-së